

## MARRËVESHJE

PËR

### KRIJIMIN E KOALICIONIT "Djathtas për Zhvillim"

Sot më datë 03.03.2025, Ne, një grup partish politike, duke besuar:

Se Shqipëria është në një fazë kritike të zhvillimit të saj dhe pushteti publik ka deficit të legjitimitetit demokratik, dhe se në Parlamentin e dalë nga zgjdhjet e 11 majit 2025 qytetarët duhet të përfaqësohen realisht dhe zëri i tyre duhet të dëgjohet;

Se Shqipëria ka nevojë për një demokraci funksionale, ku pushtetet të jenë realisht të ndara dhe të balancuara, ndaj ndryshimi i modelit politik, përtej rotacionit qeverisës, është një domosdoshmëri;

Se sistemi zgjedhor është i pabarabartë mes partive politike. Ai rrezikon të deformojë vullnetin e zgjedhësve dhe të prishë garën e hapur, duke krijuar rezultat të pandershëm në favor të partive të vjetra që kanë dominuar skenën politike prej dekadash dhe që janë bashkëautore të këtij sistemi zgjedhor;

Në rëndësinë historike që ka votimi për herë të parë i shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë shtetit dhe duke ndarë bindjen se diaspora duhet të përfaqësohet realisht në Parlament;

Se proçesi i integrimit evropian ka nevojë për një pakt efektiv me qytetarët shqiptarë dhe ndryshim të mendësisë politike, duke forcuar dialogun politik me njerëzit dhe për njerëzit;

Se vlerat themelore të secilës parti janë më të rëndësishme se sa ide të veçanta programore që na ndajnë dhe se koalicioni bazohet në respektin e ndërsjellë për identitetin social, politik dhe programor të anëtarëve të tij;

#### VENDOSËM:

- Të formojmë një Koalicion elektoral dhe për të konkuruar së bashku në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 Maj 2025.
  - Emri i koalicionit është: "Djathtas për Zhvillim"
  - Shkronjat nistore të Koalicionit do të janë: "DZh".
  - Partitë përbërëse të koalicionit janë Lëvizja për Zhvillim Kombëtar dhe Djathtas 1912.
  - Sigla e koalicionit është sipas modelit bashkëlidhur kësaj marrveshje.



[shqiptarja.com]



Duke vlerësuar maksimalisht punën e SPAK dhe GJKKO në luftën kundër korruptionit në nivele të larta, krimít të organizuar dhe përpjekjet për parandalimin dhe ndëshkimin e krimít zgjedhor; duke vlerësuar arritjet e këtyre organeve në çuarjen para drejtësisë të të korruptuarve dhe krimin e standarteve të reja të përballjes me ligjin të gjitha partitë e Koalicionit angazhohen që para, gjatë dhe pas fushatës zgjedhore, të jasin kontributin e tyre, përfshirë edhe votimin në parlament, për mbrojtjen e sistemit të drejtësisë në përgjithësi, dhe SPAK dhe GJKKO në veçanti, nga presionet politike duke garantuar për sa është në mundësitet e tyre pavarësinë dhe paanësinë e këtij sistemi.

3. Koalicioni është në opozitë me shumicën qeverisëse. Të gjitha partitë e koalicionit angazhohen që përpara, gjatë dhe pas fushatës zgjedhore të mos kenë asnjë formë bashkëpunimi me maxhorancën. Veçanërisht partitë angazhohen që pavarësish rezultatit zgjedhor, individual apo si koalicion, asnjë prej tyre nuk do të nuk do të mundësojë krimin e një maxhorance qeverisëse duke u bashkuar në një koalicion qeverisës me maxhorancën aktuale apo subjekte politike që janë në aleancë të heshtur me të.
4. Në këtë koalicion drejtimi është kolegjal. Asnjë nga partitë pjesmarrëse nuk ka rol kryesor apo dytësor në raport me partitë e tjera. Drejtimi i koalicionit bëhet kolegjialisht nga një grupim i krijuar me përfaqësues të të gjithë partive pjesmarrëse.
5. Drejtuesi politik i koalicionit është Kryetari i Partisë Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, Dashamir Shehi, emri i të cilit do të rezultojë edhe në fletën e votimit.
6. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet, sipas parashikimeve të neneve 65 e vijues të Kodit Zgjedhor ushtrohen nga Partia Djathtas 1912.
7. Të autorizojmë z. Rezart Kthupi, ose të autorizuarin prej tij, si të vetmin person/ autoritet që në emër dhe për llogari të koalicionit ka të drejtë të:
  - a. paraqesë kërkesë për regjistrimin e Koalicionit, së bashku me këtë marrëveshje, pranë KQZ-së.
  - b. nënshkruarajë dhe të depozitojë pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) listën e kandidatëve për deputetë si dhe çdo dokumentacion tjetër të nevojshëm për regjistrimin e koalicionit dhe kandidatëve, deri në përfundim të procesit zgjedhor.
  - c. përfaqësojë Koalicionin gjatë procedurës së shortit, në KQZ, për renditjen e subjekteve zgjedhore në fletën e votimit.
  - d. caktojë vëzhguesit e Koalicionit në KAZA-të, KQV-të dhe VNV-të, në të gjithë vendin.
  - e. përfaqësojë Koalicionin dhe/ose të autorizojë përfaqësues të tjerë, për t'a përfaqësuar atë pranë KQZ, Kolegit Zgjedhor ose instancave të tjera administrative dhe gjyqësore ku do të konsiderohet e nevojshme.



[shqiptarja.com]



8. Lista e kandidatëve për deputetë hartohet mbi parimin e barazisë dhe interesit më të lartë të koalicionit. Kandidatët në listën e Koalicionit, pavarësisht se cilës parti i përkasin, do të konsiderohen dhe vlerësohen si kandidatë vetëm të Koalicionit, duke shbangur trajtimin e tyre sipas përkatësive partiake.
9. Partitë pjesëmarrëse në koalicion angazhohen që të zbatojnë, brenda kuadrit ligjor në fuqi, konkurrimin me "lista të hapura" për zgjedhjet e datës 11 maj 2025 duke u dhënë mundësi zgjedhësve që të jenë ata që përcaktojnë kandidatin për deputet që duhet t'i përfaqsojë në Kuvendin e Shqipërisë.
10. Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë ditën e nënshkrimit të saj.

PARTITË:

1. LEVIZJA PER ZHVILLIM KOMBETAR  
Naohuni Thelci  
Dukeli Agem Sphingia  
Sotumi



2. DJATHTAS 1912.  
Enkecëdo Arberaj  
Arbi Krasniqi  
Edvin Kulluri  
Edlira Devollli  
Eva Vako  
Criselda Gjelaj Qumbari  
Agroca Topçiqi





[shqiptarja.com]

"HQIPERI"

**DJATHHTAS  
PËR  
ZHVILLIM**



[shqiptarja.com]